

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Shqipëria, me kostot më të larta të prodhimit bujqësor në rajon
ADRESA	https://piranjat.al/social/shqiperia-me-kostot-me-te-larta-te-prodhimit-bujqesor-ne-rajon-i103863
BURIMI	piranjat.al
GJENDJA	online

KOHË


KAPUR NGA NE	13 shtator 2026, 07:22:29 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	13 shtator 2026, 07:16:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	d0aa12d3b3d59bcd9c05669792134367766cad45ffba16fe5573e9aa2b25a677
TEKSTI	9023315839bcc8b41200b0e050112d7edee3ba9149bdf666439dbe01438c439c
PAMJA	07cf0b5cbaa7dcd8ecc44a94ea7d95be4920a72d56ded79228aa969a685c0885

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	137001843293b57bc28fa95b51239154e147d4cf64a562f32cdc84554ed61ea4
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërin nga tri gjendjet — **nuk u gjet, në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/137001843293b57bc28fa95b51239154e147d4cf64a562f32cdc84554ed61ea4>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored · dritarja 1280×1024 px

- EDITORIAL
- EMISIONE
- INVESTIGIME
- AKTUALITET
- SOCIALE
- POLITIKE
- KOSOVA
- BOTA
- SHOWBIZ
- LIFESTYLE
- SPORT

SYRI LIVE



Flash: **Unaza** rrethojnë Krye... **Shtatë** policia në vendngjarje ka **së** policëve një ndryshim që përfundon me një **mbuluar** nga balta denoncojnë në redaksinë e **Shqiptarët** e bashkuar mbushur plot. Kjo, pasi në mbështetje **është** "fri

SOCIALE

Shqipëria, me kostot më të larta të prodhimit bujqësor në rajon

Piranjat Përditësimi i fundit 13 Shtator 2026, 09:16



Shqipëria, me kostot më të larta të prodhimit bujqësor

Fermerët shqiptarë përballen me kosto më të larta prodhimi se konkurrentët e tyre në rajon, si pasojë e varësisë së madhe nga inputet e importuara, mbështetjes së ulët financiare nga shteti, mungesës së fuqisë punëtore dhe dobësive në infrastrukturën bujqësore. Kombinimi i këtyre faktorëve e bën prodhimin vendas më të shtrenjtë dhe dobëson konkurrueshmërinë e tij përballë produkteve që vijnë nga Serbia, Maqedonia e Veriut dhe vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor. Sipas raporteve të Organizatës së Kombeve të Bashkuara për Ushqimin dhe Bujqësinë (FAO), fermerët e vegjël në rajon, veçanërisht ata në Shqipëri, shpenzojnë mesatarisht rreth 28% të vlerës së përgjithshme të prodhimit vetëm për blerjen e farërave, plehrave kimike dhe pesticideve.

Pjesa më e madhe e këtyre inputeve sigurohet nga importi, ndaj kostot e fermerëve ndikohen drejtpërdrejt nga çmimet ndërkombëtare, kursi i këmbimit dhe shpenzimet e transportit. Për fermat e vogla, të cilat dominojnë strukturën e bujqësisë shqiptare, mundësitë për të blerë me shumicë dhe për të negociuar çmime më të favorshme janë të kufizuara. Një nga arsyet kryesore që e vendos bujqësinë shqiptare në pozita më të pafavorshme është niveli i ulët i subvencioneve të drejtpërdrejta.

Të dhënat e raportuara ndër vite tregojnë se vendet e tjera të rajonit kanë dhënë mesatarisht mbi 53 euro mbështetje direkte për hektar, ndërsa në Shqipëri, kjo mbështetje është llogaritur historikisht në rreth 3 euro për hektar. Diferenca është afërsisht 18 herë. Ky hendek do të thotë se fermeri shqiptar duhet të përballojë nga të ardhurat e veta një pjesë shumë më të madhe të kostove. Në vendet fqinje, subvencionet mbulojnë një pjesë të shpenzimeve për inputet, karburantin, mekanikën bujqësore ose investimet, duke mundësuar që produkti të dalë në treg me çmim më konkurrues. Për pasojë, produktet shqiptare përballen me konkurrencë jo vetëm nga prodhimi i Bashkimit Europian, por edhe nga mallrat bujqësore të vendeve të rajonit që kanë politika më të qëndrueshme mbështetëse.

Kostove të drejtpërdrejta u shtohen edhe humbjet që burojnë nga ndryshimet klimatike, natësisht dhe infrastruktura e pamjaftueshme e ujitjes. Raporti i FAO-s mbi gjendjen e ushqimit dhe bujqësisë evidenton se kostot e fshehura të sistemit bujqësor, ku përfshihen dëmet mjedisore dhe humbjet e shkaktuara nga ndryshimet klimatike, rëndojnë më shumë mbi vendet me të ardhura dhe kapacitete investuese më të kufizuara.

Në Shqipëri dhe në vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor, mungesa e sistemeve moderne të ujitjes e rrit varësinë e prodhimit nga kushtet atmosferike. Një sezon i thatë mund të ulë ndjeshëm rendimentin, ndërsa shpenzimet për punimin e tokës, farërat, plehrat dhe pesticidet mbeten të njëjta. Kjo e rrit më tej koston për njësi prodhimi dhe rrezikun financiar të fermerit. Një tjetër presion i fortë vjen nga mungesa e fuqisë punëtore. Emigrimi dhe largimi i popullsisë nga zonat rurale kanë reduktuar numrin e punëtorëve të disponueshëm në bujqësi.

Mungesa është veçanërisht e ndjeshme gjatë periudhave të mbjelljes dhe vjeljes, kur kërkesa për punëtorë rritet brenda një kohe të shkurtër. Fermerët detyrohen të ofrojnë paga ditore më të larta, ndërsa në shumë raste, prodhimi nuk mbledhet në kohë ose një pjesë e tij mbetet në parcela. Varësia nga inputet e importuara, subvencionet shumë më të ulëta se në vendet fqinje, rendimentet e kufizuara, problemet me ujitjen dhe shtrenjtimi i fuqisë punëtore po krijojnë një barrë të shumëfishtë për bujqësinë shqiptare.

Pa një rritje të mbështetjes dhe investimeve që ulin koston për njësi, fermerët vendas rrezikojnë të humbasin më tej terren përballë importeve dhe prodhuesve të subvencionuar të rajonit./Monitor

Artikuj te sugjeruar

SOCIALE 13 Shtator08:28

[Pse i kemi çmimet kaq të shtrenjta ?! TVSH e ushqimeve, ndër më të lartat në Europë](#)

Qeveria po kërkon ta frenojë shtrenjtimin e ushqimeve përmes "PriceWatch", një platformë që do t'u mundësoj...

SOCIALE 11 Shtator13:00

[Rritet emigrimi, 69 mijë shqiptarë morën leje qëndrimi në BE në 2025](#)

Tendenca e emigracionit është përshpejtuar sërish vitin e fundit, sipas të dhënave indirekte nga Eurostat, që raporton leje...

SOCIALE 11 Shtator09:43

[Inflacioni 3.2% në gusht, transporti dhe ushqimet ndikojnë në rritjen e çmimeve](#)

Inflacioni në Shqipëri u rrit në 3.2% në gusht 2026, duke shënuar një përshpejtim të ndjeshëm krahasuar me të...

SOCIALE 11 Shtator07:13

[Të rinjtë ikin, por dhe ata që mbeten nuk kanë ku punojnë, papunësia e tyre rritet 16%](#)

Shqipëria po humbet popullsi dhe veçanërisht të rinj, por tkurja e kësaj grup-moshe nuk po shoqërohet me një lehtës...

SOCIALE 10 Shtator23:51

Denoncimi nga Tropoja/ Banori i fshatit Geghysen: Rruga në gjendje të degraduar, fondet i devijuan për një rrugë tjetër

Një banor nga fshati Geghysen i Tropojës ka ngritur shqetësimin për gjendjen e rrugës në fshatin e tij që e lidh atë m...

SOCIALE 10 Shtator18:29

Zjarret/ ISHP: Tymi ka ndikim në shëndetin publik të grupeve në risk

Shqipëria po përballët prej disa muajsh me vatra të vazhdueshme zjarri. Veç impaktit mjedisorë, specialistët e ISHP thonë s...

SOCIALE 10 Shtator17:30

SKANDAL/ Vidhen 160 mijë dollarët e dhuruara për nënën dhe djalin me spektrin autik

Rasti i nëna File dhe djalit me spektrin autik, Andi, preku zemrat e shqiptarëve gjatë muajit korrik. Nëna dhe djali i saj 19-vjeçar,...

SOCIALE 10 Shtator07:04

Azilet kërkojnë staf jashtë vendit, filipinasit dhe tunizianët pritet të kujdesen për të moshuarit

Shqipëria po përballët me mungesë gjithnjë e më të theksuar të fuqisë punëtore për shumë sektorë t...

SOCIALE 9 Shtator14:04

AAPSK: Të ardhurat nga qiratë e pasurive të sekuestruara rriten me 30%, afro 2 mln euro në 8 muaj

Të ardhurat që shteti siguron nga dhënia me qira e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara kanë shënuar një rritje t...

SOCIALE 9 Shtator14:05

Rezultati i PISA-s/ Studiuesi: Të dhënat e Shqipërisë me sinjal të kuq! Dyshohet se janë fasifikuar

Studiuesi Taulant Muka ka reaguar lidhur me rezultatet e Shqipërisë në raportin PISA 2025, duke ngritur shqetësime mbi mënyrën e...

ME TE VIZITUARAT

AKTUALITET 12 Shtator

EMRI- 2.4 mln euro kokainë në trëndafila/ Kush ...

Personi i arrestuar në Greqi si kreu i grupit të trafikut të kokakinës nga Kolumbia përmes trëndafilave është Lulzim Cak...

AKTUALITET 12 Shtator

Pritë me armë në Greqi, ‘policët’ e rremë bllok...

Një arratisje spektakolare ka ndodhur mbrëmjen e së premtes në Greqi, gjatë transferimit të një të burgosuri nga Burgu...

Nga Elton Qyno AKTUALITET 12 Shtator

"Bëmë takim familjar"-Flet Ziza Pajaziti: Ja si...

Modelja kosovare Ziza Pajaziti, e cila në datat 12 dhe 13 qershor 2025 rezulton të ketë hyrë në ambientet e burgut të siguris&eu...

INVESTIGIME 31 Maj14:01

Gratteri për Piranjat: Kam 38 vite që më duan të vdekur ndaj nuk dal kurrë në publik

Për më shumë se tre dekada, jeta e kryeprokurorit italian të antimafias, Nicola Gratteri, ka qenë nën hijen e kërcënimev...

video



Reagon Clevio!



Reagon Clevio!



Matilda,Piranja jonë vegjetariane: gjatë javës kap të korruptuarit, të dielën thyen rekorde në male!



Deklarata e Gjestit!



7 September 2026



Pamje apokaliptike nga Puka!



7 September 2026



Aida, piranja jonë e parë, rikthehet në skuadër më e motivuar se kurrë për të kapur maniakët.



Qytetarët na frymëzojnë çdo ditë. Bisedat e mikpritja e tyre na japin motiv për punën me pasion.



Luela Gaxhja, “stari” i Piranjave, që kërkon çdo ditë rritje rroge.



5 September 2026



5 September 2026



Florjan Binaj rikonfirmon: Do kandidoj sërish si kandidat i pavarur



Edon Kuqi/Piranja jonë politike që ngatërroi ëndrrën e gazetarit me atletin 100m.



Dyshime për zjarrvënie të qëllimshme



Humbi jetën në aksidentin tragjik, një muaj më parë i propozoi për martesë.



Qytetarja denoncon me video ngacmimin ne autobus. #news



Si u tentua të shantazhohej me 100 mijë euro shefi i kabinetit të Përparim Ramës përmes mediave



PIRANJAT SHOW - SEZONI 9 EPISODI 16



Gruaja me dy identitete që premtan “shërim” me ujin e kufomave në Pejë



A ka Shqipëria një Nicola Gratteri?



Katër nëna në kërkim të fëmijeve/ Bisedat që zbuluan rrjetin e errët



Flamur Gjuzi, i dënuar për "shpërdorim detyre" sot drejtor i Policisë Bashkiake, sërish shkel ligjin?



Pallatet u zhytën “Durrës Marina” dhe Autoriteti Portual bëjnë veprimin e papritur përballë skandalit



Ekskluzive/ Nicola Gratteri çmonton skemën e pastrimit të parave të ndërtimit në Tiranë



PIRANJAT SHOW - SEZONI 9 EPISODI 15



Enkel Demi duke luftuar paragjykimet për shqiptarët. (kamera e fshehtë)



Milva Ekonomi i firmosi miliona euro Vilma Nushit, kjo e fundit i investoi te kulla e Ervin Matës



Ajo çfarë mund të na mësojë Kosova.



Laboratorë “copy-paste”/ I njëjti mjek firmos analiza në disa pika, skema që ngre pikëpyetje



Rrjeti i ‘errët’ i vajzave të zhdukura! Bisedat tronditëse si funksiononte grupi.



Bleu 300 m2 tokë në vitin 2004, kthehet nga emigrimi dhe gjen aty vilë 3-katëshe.



“Na detyruan nga Dubai”/ Konstruktori i Durrës Marina zbulon pse u zhytën pallatet



Drejtori që tregon sjellje të pahijshme me nxënësen: Jam i fortë edhe në parti



PIRANJAT SHOW - SEZONI 9 EPISODI 14



Turisti zemërgjerë nga Italia dhe patatinat falas



Aksidentet “pushtojnë” oborrin e familjes në Klos, banori: Një ditë do ndodhë tragjedi



Lidhja jashtëmartesore që përfundoi në makth /32-vjeçarja rrëfen shantazhin me video intime



Sherr në terminalin e Peshkopisë, shoferi: Mos më vidh pasagjerët! Shko ha bukë te pjesa jote



Artisti dhe Frika



Si u kthye në urrejtje dashuria mes ish-bashkëshortëve dhe ‘lufta’ për 200 mijë euro!



14-vjeçare me dr*gë dhe pro*titucion, rrjeti i errët i minoreneve të zhdukura





Zhytja e pallateve te Alabarit/ IKMT pranon anomalitë në “Durrës Marina”: Janë zhytur 28 cm



"Ederlezi", festa e veçantë e komunitetit rom.



PIRANJAT SHOW - SEZONI 9 EPISODI 13



Do t'i fus duart edhe nëse bërtet, motra e 13 vjeçares rrëfen tmerrin e mesazheve që mësuesi ia çon



“Inspektori gjobëvënës” i bashkisë terrorizon qytetarët



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.